



KOMUNA E NOVOBËRDËS

Bazuar në nenin 8, paragrafi 3, pika 2 të Rregullores MF-Br-04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat për financimin publik të OJQ-ve, Komuna e Novobërdës më 23.02.2026, publikon sa vijon:

THIRRJE PUBLIKE

Për përzgjedhjen e 2 përfaqësuesve të Komisionit të Vlerësimit nga grupi i ekspertëve të jashtëm

1. Ftohen personat e interesuar dhe përfaqësues të organizatave joqeveritare (OJQ) të dorëzojnë Aplikacione për përzgjedhjen e anëtarit të Komisionit për vlerësimin e ofertave të paraqitura në Thirrjen Publike për mbështetje financiare publike të projekteve/programeve të organizatave joqeveritare në fushën e mbrojtjes së qytetarëve në situata emergjente.
2. Kandidatët duhet të kenë përvojë disavjeçare në punë me organizata joqeveritare ose agjenci të pavarura dhe të mos kenë qenë të dënuar për vepra penale.
3. Kandidatët e përzgjedhur kryejnë detyrën e anëtarit të Komisionit Vlerësues pa shpërblim, në përputhje me përcaktimet e Rregullores MF-Br-04/2017 për kriteret, standardet dhe procedurat e financimit publik të OJQ-ve.
4. Afati i fundit për paraqitjen e aplikimit është nga data 23 .02. 2026 deri më 04.03. 2026.
5. Së bashku me Aplikacionin është e nevojshme të paraqisni një CV të shkurtër me të dhëna për përvojën e punës.
6. Aplikimet mund të dorëzohen personalisht në qendrën për shërbime qytetare të komunës së Novobërdës në Bostan.

Kryetari i Komunës

Sasa Milosevic